

Fletë informuese për fruthin

Çfarë është fruthi

Infeksioni i fruthit shkaktohet nga një virus, dhe përhapet mes njerëzve shumë lehtë. Sapo të fillojnë simptomat, njerëzit mund të sëmuren shpejt. Ju mund të kapni fruthin në çdo moshë, por shpesh janë fëmijët e vegjël që e kapin atë.

Si përhapet fruthi

Ju mund të kapni fruthin nëpërmjet kontaktit të ngushtë me dikë që ka fruth. Kjo mund të jetë nga ajri kur kolliten ose teshtijnë, ose duke prekur gjëra që dikush me fruth ka kollitur ose teshtitur. Fruthi përhapet shumë lehtë në familje dhe në vende të tjera ku njerëzit përzihen ngushtë së bashku.

Ju mund të mbroheni nga kapja e fruthit nëse keni pasur 2 doza të vaksinës së fruthit, shytave dhe rubeolës (MMR), ose nëse keni pasur infeksionin më parë.

Një person me fruth mund ta përhapë infeksionin brenda 4 ditëve para se të marrë skuqjen deri në 4 ditë pasi të zhvillojë skuqjen e tyre.

Simptomat e fruthit

Simptomat e fruthit zakonisht fillojnë nga 10 deri në 12 ditë pas kapjes së infeksionit. Ndonjëherë mund të duhen deri në 21 ditë që çdo simptomë të shfaqet.

Fruthi zakonisht fillon me simptoma të ngjashme me të ftohtin. Simptomat e para të fruthit përfshijnë:

- temperaturë e lartë
- hundë që rrjedhin ose të bllokuar
- teshtitje
- kollitje
- sy të skuqur, që lotojnë

Njollat e vogla të bardha mund të shfaqen brenda faqeve dhe në pjesën e prapme të buzëve disa ditë më vonë. Këto njolla zakonisht zgjasin disa ditë.

Një skuqje zakonisht shfaqet 2 deri në 4 ditë pas fillimit të simptomave të ngjashme me të ftohtin. Skuqja fillon në fytyrë dhe pas veshëve para se të përhapet në pjesën tjetër të trupit.

Njollat e skuqjes së fruthit ndonjëherë mund të rriten. Ata mund të bashkohen për të formuar arna me njolla. Ato zakonisht nuk kruhen.

Skuqja duket ngjyrë kafe ose e kuqe në lëkurë të bardhë. Mund të jetë më e vështirë për t'u parë në lëkurën kafe dhe të zezë.

Sa serioze është fruthi?

Rreth 1 në 15 njerëz me fruth mund të sëmuren seriozisht. Fëmijët më të vegjël, gratë shtatzëna dhe njerëzit me sistem imunitar të dobësuar kanë më shumë gjasa të sëmuren seriozisht.

Komplikimet më serioze të fruthit mund të përfshijnë:

- infeksionet e veshit
- infeksioni i mushkërive (pneumonia)
- diarre
- dehidratim
- konvulsione (të cilat janë më pak të zakonshme)

Infeksioni i fruthit gjatë shtatzënisë mund të rezultojë në humbjen ose lindjen e parakohshme të foshnjës.

Parandalimi i fruthit

Marrja e vaksinës MMR është mënyra më e mirë për të parandaluar fruthin.

Vaksina zakonisht u jepet fëmijëve në dy doza. Doza e parë u jepet fëmijëve të moshës 12 muajshe, dhe doza e dytë jepet pasi të jenë 3 vjeç e 4 muajsh.

Nëse fëmija juaj identifikohet si një kontakt i ngushtë i dikujt me fruth, ndonjëherë mjeku juaj mund të rekomandojë që vaksina MMR të jepet më herët se këto doza të planifikuara. Nëse një dozë i jepet një foshnjeje të moshës nën 12 muaj atëherë 2 dozat e zakonshme të MMR prapë duhet të jepen në momentet e zakonshme (me një diferencë minimale prej 1 muaji midis çdo doze).


Nëse dikush ka lëshuar një dozë ose nuk është i sigurt nëse ka kryer ndonjë vaksinim, vaksina mund të jepet në çdo moshë. Prindërit dhe kujdestarët mund të kontrollojnë librezën e kuqe të fëmijës së tyre për të dhënat e tyre të vaksinimit.

Gratë shtatzëna ose njerëzit me sistem imunitar të dobësuar nuk duhet të marrin vaksinën. Nëse mendojnë se kanë pasur kontakt me dikë me fruth, duhet të flasin me mjekun e tyre të përgjithshëm ose me maminë e tyre për këshilla të mëtejshme.

Për më shumë informacione mbi vaksinimet MMR vizitoni:

<http://www.nhs.uk/conditions/vaccinations/mmr-vaccine>

Ose skanoni kodin QR:



Të qëndruarit larg njerëzve të tjerë nëse jeni të sëmurë me fruth

Një person me fruth mund ta përhapë infeksionin brenda 4 ditëve para se të marrë skuqjen. Pasi një person ka skuqje, ata prapë mund të përhapin infeksionin edhe për 4 ditë të tjera.

Nëse një profesionist i kujdesit shëndetësor ju ka thënë se mund të keni fruthin, duhet të qëndroni larg kujdesit për fëmijët, shkollës ose punës për të paktën 4 ditë nga koha kur është shfaq për herë të parë skuqja. Ju mund të ktheheni në aktivitetet tuaja normale pas 4 ditëve nëse ndjeheni mirë dhe nuk keni më temperaturë.

Trajtime për njerëzit me fruth

Gjenjda nga fruthi zakonisht fillon të përmirësohet brenda një jave.

Mund të jetë e dobishme të pushoni dhe të pini shumë lëngje, siç është uji, për të shmangur dehidrimin.

Fruthi ndonjëherë mund të shkaktojë sëmundje të tjera. Mund t'ju jepen antibiotikë për t'i trajtuar.

Nëse një profesionist i kujdesit shëndetësor ju ka thënë se mund të keni fruthin dhe të mendoni se ju ose fëmija juaj po zhvillon efekte më serioze për shëndetin, duhet të kontaktoni mjekun tuaj të përgjithshëm.

Më shumë informacione mbi fruthin janë në dispozicion në:

<http://www.nhs.uk/conditions/measles>

Ose skanoni kodin QR:

